

31994L0055

Direktiva e Këshillit 94/55/KE, datë 21 nëntor 1994, mbi përfrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë tokësore

Gazeta Zyrtare L 319, 12.12.1994, fq. 0007-0013

KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe në veçanti nenin 75 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh opinionin e Komunitetit Ekonomik dhe Social [2],

Duke vepruar sipas procedurës së parashtruar në nenin 189 c të Traktatit [3],

(1) Duke pasur parasysh se, me kalimin e viteve, transporti kombëtar dhe ai ndërkombëtar i mallrave të rrezikshme me rrugë tokësore është rritur në mënyrë të konsiderueshme, duke shtuar rreziqet në rast aksidenti;

(2) Duke pasur parasysh se të gjitha Shtetet Anëtare, përveç Irlandës, janë palë kontraktuese të Marrëveshjes Europiane në lidhje me Transportin e Mallrave të Rrezikshme me Rrugë Tokësore (ADR), fusha gjeografike e veprimit e së cilës e jkallon kufirin e Bashkimit dhe përcakton ligjet bazë për sigurinë e transportit ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme me rrugë tokësore; duke pasur parasysh se si pasojë është e pranueshme që ligje të tilla të përfshijnë trafikun kombëtar me qëllim harmonizimin brenda Komunitetit, kushtet sipas të cilave mund të transportohen mallrat e rrezikshme me rrugë tokësore;

(3) Duke pasur parasysh se nuk ka legjislacion komunitar që përfshin të gjitha masat e kërkuara për të garantuar transport të sigurtë të mallrave të rrezikshme dhe masat kombëtare përkatëse ndryshojnë nga një Shtet Anëtar te tjetri; duke pasur parasysh se ato divergjenca janë pengesa për ofrimin e lirë të shërbimeve të transportit dhe për më tepër, për lëvizjen e lirë të mjeteve dhe pajisjeve të transportit; duke pasur parasysh se me qëllim tejkalimin e asaj pengese, duhet të përcaktohen rregulla të njëtrajtshme dhe të zbatueshme për të gjithë transportin brenda Komunitetit;

(4) Duke pasur parasysh se një veprim i kësaj natyre duhet të zbatohet në nivel Komuniteti për të siguruar përputhje me një legjislacion tjetër të Komunitetit, të sigurojë një shkallë të kënaqshme harmonizimi me qëllim lehtësimin e lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve, si dhe të garantojë një nivel të lartë sigurie për operacionet e transportit kombëtar e ndërkombëtar;

(5) Duke pasur parasysh se dispozitat e kësaj direktive janë pa paragjykuar angazhimet e hyra në nga Komuniteti dhe Shtetet e tij Anëtare, në përputhje me qëllimet e parashtruara në Axhendën 21, Kapitulli 19, në Konferencën UNCED në korrik 1992 në Rio de Janeiro, për t'u përpjekur për harmonizimin e ardhshëm të sistemeve mbi klasifikimin e substancave të rrezikshme;

(6) Duke pasur parasysh se nuk ka ende asnjë legjislacion komunitar specifik që qeveris kushtet e sigurta, sipas të cilave agjentët biologjik dhe mikroorganizmat e modifikuara, të rregulluara sipas Direktivave të Këshillit 90/219/KEE [4], 90/220/KEE [5] dhe 90/679/KEE [6], duhet të transportohet;

(7) Duke pasur parasysh se kjo direktivë merr parasysh politikat e tjera të Komunitetit në fushat e sigurisë së punëtorëve, mjetet e ndërtimit dhe mbrojtjen e ambjentit;

(8) Duke pasur parasysh se Shtetet Anëtare mbeten (janë) të lira për të rregulluar operacionet për transportin e mallrave të rrezikshme të transportuara brenda territorit të tyre nga një mjet që nuk mbulohet nga direktivat, pavarësisht ku është i regjistruar mjeti;

(9) Duke pasur parasysh se Shtetet Anëtare duhet të jenë të afta të zbatojnë rregulloret e veçanta të trafikut rrugor në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme brenda territoreve;

(10) Duke pasur parasysh se Shtetet Anëtare duhet të jenë të afta të ruajnë kërkesat e kontrollit të cilësisë, ashtu siç e konsiderojnë disa operacione të transportit kombëtar deri në kohën që Komisioni i raporton Këshillit mbi këto çështje;

(11) Duke pasur parasysh se dispozitat e ADR-së autorizojnë përfundimin e marrëveshjes duke shmangur tërheqjen prej kësaj, dhe ndërkohë numri i madh i marrëveshjeve të përfunduara në mënyrë dypalëshe (bilaterale) mes Shteteve Anëtare pengon dispozitat e lira të shërbimeve të transportit të rrezikshëm të mallrave; duke pasur parasysh se duke përfshirë dispozitat e nevojshme në shtojcat e kësaj direktive duhet ta tejkalojnë nevojën për shmangie të tilla; duke pasur parasysh se dispozita duhet të bëhet për një periudhë kalimtare, gjatë të cilës Shtetet Anëtare vazhdojnë të zbatojnë marrëveshjet, tashmë të bëra mes tyre;

(12) Duke pasur parasysh se është e nevojshme që dispozitat e ADR-së të kthehen në ligj të Komunitetit, duke përfshirë kërkesat që kanë të bëjnë me ndërtimin e mjeteve që transportojnë mallrat e rrezikshme; duke pasur parasysh se në këtë kontekst, dispozita duhet të bëhet për një periudhë kalimtare, në mënyrë që Shtetet Anëtare të ruajnë në mënyrë të përkohshme disa dispozita kombëtare specifike mbi kërkesat e prodhimit për mjetet e regjistruara kombëtare;

(13) Duke pasur parasysh se procedurat e informacionit ekzistues, në fushën që ka lidhje me propozimet legjislative kombëtare, duhet të përdoren me qëllim rritjen e transparencës për të gjithë operatorët ekonomikë;

(14) Duke pasur parasysh se, për sa i përket transportit kombëtar, Shtetet Anëtare duhet të ruajnë të drejtën të zbatojnë ligjet në përputhje me rekomandimet e shumëllojshme të Kombeve të Bashkuara në transportin e mallrave të rrezikshme, deri tani ADR-ja nuk është harmonizuar akoma me ato rregulla, të cilat kanë për qëllim të lehtësojnë transportin intermodal të mallrave të rrezikshme;

(15) Duke pasur parasysh se Shtetet Anëtare rregullojnë dhe ndalojnë transportin e disa mallrave të rrezikshme me rrugë tokësore brenda territoreve të tyre, por vetëm me arsye (për disa arsye),

përveç asaj të sigurisë; duke pasur parasysh se në të njëjtin kontekst Shtetet Anëtare mund të ruajnë të të drejtën në rastin e disa trasporteve të substancave të rrezikshme, me qëllim imponimin e transportit me rrugë hekurudhore ose me rrugë të brendshme ujore, ose mund të bëjnë kujdes të veçantë për paketimin e disa substancave të rrezikshme;

(16) Duke pasur parasysh se Shtetet Anëtare, për qëllimet e kësaj direktive, duhet të jenë të afta të zbatojnë ligje më të rrepta ose më të buta në lidhje me disa operacione transporti të kryera brenda territoreve të tyre me mjetet e regjistruara aty;

(17) Duke pasur parasysh se harmonizimi i kushteve duhet të marrëparasysh rrethanat kombëtare të veçanta, dhe prandaj kjo direktivë duhet të jetë mjaft fleksibël duke iu ofruar Shteteve Anëtare mundësinë e dhënies së disa shmangieve; duke pasur parasysh se zbatimi i zhvillimeve të reja teknologjike dhe industriale nuk duhen penguar prandaj dispozita duhet të bëhet për shmangie të përkohshme;

(18) Duke pasur parasysh se shtetet e regjistruara në vendet jo anëtare, duhet të lejohen të kryejnë transportin ndërkombëtar brenda territoreve të Shteteve Anëtare, nëse ato përputhen me ADR-në;

(19) Duke pasur parasysh se duhet të mundësohet përshtatja e shpejtë e kësaj direktive në progresin teknik, me qëllim që të merren parasysh dispozitat e reja të të përfshira në ADR, dhe të vendosin mbi zbatimin e masave emergjente në rast aksidentesh apo incidentesh; duke pasur parasysh se me këtë qëllim duhet të krijohet një komitet dhe të nisë një procedurë për bashkëpunim më të ngushtë mes Shteteve Anëtare dhe Komisionit që gjendet brenda këtij Komiteti;

(20) Duke pasur parasysh se shtojcat e kësaj direktive përmbajnë dispozita që kanë të bëjnë me trajnimin profesional të disa shoferëve të automjeteve, të cilët transportojnë mallra të rrezikshme me rrugë tokësore; prandaj Direktivat e Këshillit 89/684/KEE, datë 21 dhjetor 1994, me rastin e trajnimit profesional për disa shoferë automjeteve të cilët transportojnë mallra të rrezikshme me rrugë tokësore, duhet të shfuqizohen

KA MIRATUAR KËTË DIREKTIVË

KAPITULLI I QËLLIMET, PËRKUFIZIMET DHE DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Kjo direktivë zbatohet për transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë tokësore brenda ose midis Shteteve Anëtare. Kjo nuk zbatohet për transportin e mallrave të rrezikshme me mjete që u përkasin forcave të armatosura, apo që janë në përgjegjësinë e tyre.

2. Megjithatë, kjo direktivë nuk ndikon në të drejtën e Shteteve Anëtare, duke mbajtur parasysh ligjin e Komunitetit, të parashtrijë kërkesa që kanë lidhje me:

(a) transportin kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme brenda territoreve të tyre të kryera me mjete të pambuluara nga kjo direktivë;

(b) rregullat e qarkullimit rrugor, të cilat janë specifike për transportin kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme;

(c) kontrollet e cilësisë në sipërmarrje, në përputhje me standardet e ISO-os 9001 dhe 9002, ku ato kryejnë operacionet e transportit kombëtar, duke përfshirë:

(i) substanca eksplozive dhe artikuj të Klasit 1, ku sasia e substancës eksplozive që transportohet tejkalon:

- 1 000 kg për ndarje 1.1, ose
- 3 000 kg për ndarje 1.2, ose
- 5 000 kg për ndarjet 1.3 dhe 1.5;

(ii) substanca shumë të rrezikshme në cisterna ose në cisterna mbajtëse, me një aftësi që i tejkalon 3 000 litra, janë:

- Substanca të Klasit 2
- Gaz i klasifikuar ... (at)
(bt)
(b)
(ct)
(c)

- gazet e lëngshme në ngrirje të thellë prej 7° (b) dhe 8° (b),

- substanca të Klasit 3, 4.1, 4.2, 4.3, 5.1, 5.2, 6.1 dhe 8

- që nuk renditen nën (b) ose (c) në ato klasa, ose

- të renditura aty, por që kanë një kod të rrezikshëm me dy ose me tri shifra

domethënëse (ku nuk përfshihet asnjë zero);

(iii) ambalazhet në vijim të Klasit 7 (materialet radioaktive: ambalazhet e materialeve të zbrërthyeshme, ambalazhet e tipit B (U), ambalazhet e tipit B (M).

Fusha e veprimit e dispozitave kombëtare në lidhje me këto kërkesa nuk mund të zgjerohet.

Dispozita në fjalë nuk zbatohet nëse masa të tilla janë bërë të detyrueshme sipas dispozitave të Komunitetit. Para datës 31 dhjetor 1998 Komisioni i paraqet Këshillit një raport ku vlerëson sigurinë e aspekteve që mbulohen nga kjo dispozitë bashkë me një propozim të përshtatshëm për vazhdimin apo shfuqizimin e saj.

Neni 2

Për qëllimet e kësaj direktive:

“ADR” nënkupton Marrëveshjen Europiane në lidhje me Transportin e Mallrave të Rrezikshme me Rrugë Tokësore, të nënshkruar në Gjenevë më 30 shtator 1957, me ndryshimet përkatëse;

“mjet” nënkupton çdo automjet për përdorim në rrugë, qoftë ai i plotë apo jo, që ka së paku katër rrota dhe një shpejtësi maksimale në kushte sigurie që i tejkalon 25 km/h dhe rimorkiot e saj, me përjashtim të mjeteve që ecin në shina dhe të traktorëve pyjorë dhe bujqësorë, si dhe të gjitha makinerive të lëvizshme,

“mallrat e rrezikshme” nënkupton ato substanca dhe artikuj transporti me rrugë tokësore i të cilave ndalohet ose autorizohet vetëm në disa rrethana nga Shtojcat A dhe B të kësaj directive;

“transporti” nënkupton kryerjen e çdo operacioni të transportit rrugor nga një mjet që kalon plotësisht apo pjesërisht nëpër rrugët publike, brenda territorit të një Shteti Anëtar, duke përfshirë aktivitetin e ngarkimit dhe shkarkimit, e mbuluar nga Shtojcat A dhe B, pa cenuar marrëveshjet e përcaktuara nga ligjet e Shteteve Anëtare në lidhje me përgjegjësinë mbi operacione të tilla.

Ajo nuk përfshin tërë transportin e kryer plotësisht brenda perimetrit të një zone të mbyllur.

Neni 3

1. Pa cenuar nenin 6, mallrat e rrezikshme, transporti i të cilave ndalohej nga Shtojcat A dhe B të kësaj direktive, nuk transportohen në rrugë tokësore.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë direktivë, transporti i mallrave të tjera të rrezikshme, të renditura në Shtojcën A, është subjekt i autorizuar që të përputhet me kushtet e vendosura në Shtojcat A dhe B të kësaj direktive, në veçanti sa i përket:

(a) ambalazhimit dhe etiketimit të mallrave në fjalë, dhe

(b) ndërtimi, pajisja dhe funksionimi normal i mjeteve që transportojnë mallrat në fjalë.

KAPITULLI II SHMANGIET, KUFIZIMET DHE PËRJASHTIMET

Neni 4

Vetëm për qëllimet e operacioneve të transportit kombëtar, të kryera nga mjetet e regjistruara brenda vetë territorit, çdo Shtet Anëtar, mund të ruajë dispozitat e së drejtës kombëtare të tij për transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë tokësore, të cilat janë në përputhje me Rekomandimet e OKB-së mbi Transportin e Mallrave të Rrezikshme, derisa Shtojcat A dhe B të kësaj direktive rishikohen me qëllim reflektimin e atyre rekomandimeve. Shtetet Anëtare në fjalë, informojnë Komisionin në lidhje me rrethanat.

Neni 5

1. Pa cenuar një legjislacion komunitar tjetër, në veçanti atë të aksesit në treg, çdo Shtet Anëtar ruan të drejtën, kryesisht për arsye të ndryshme nga siguria gjatë transportit, të tilla si arsyet e sigurimit kombëtar apo të mbrojtjes së mjedisit, me qëllim rregullimin apo ndalimin e transportit të disa mallrave të rrezikshme brenda territorit të tij.

2. Rregullat e vendosuar nga një Shtet Anëtar mbi mjetet që kryejnë transport ndërkombëtar nëpër territorin e tij dhe i autorizuar nga Margjinali 10 599 i Shtojcës B, kufizohet me qëllim lokal, zbatohet për të dyja transportet, atë kombëtar dhe atë ndërkombëtar dhe nuk rezulton në diskriminim.

3.(a) Çdo Shtet Anëtar zbaton dispozita më të rrepta në lidhje me transportin, me përjashtim të kërkesave të ndërtimit, të kryera nga mjetet e regjistruara apo që qarkullojnë brenda territorit të Shtetit Anëtar.

(b) Megjithatë, Shtetet Anëtare ruajnë dispozita kombëtare specifike për qendrat e gravitetit të mjeteve të regjistruara brenda territoreve të tyre, deri sa ndryshimi, nëse ka ndonjë, i Margjinalit 211 128 i Shtojcës B të kësaj direktive, por jo, në çdo rast, pas datës 31 dhjetor 1998.

4. Nëse një Shtet Anëtar merr parasysht, se siguria e zbatimit të dispozitave ka rezultuar e pamjaftueshme, në rast aksidenti apo incidenti, me qëllim kufizimin e rrezikut të përfshirë në transport dhe nëse ekziston një nevojë urgjente për të marrë masa, ajo njofton Komisionin, në fazën përgatitore të atyre masave që propozon të merren. Veprimi në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 9, Komisioni vendos nëse zbatimi i atyre masave duhet të jetë i autorizuar dhe të përcaktojë kohëzgjatjen e tyre.

5. Shtetet Anëtare ruajnë çdo dispozitë kombëtare të zbatueshme më 31 dhjetor 1996 në lidhje me:

- transportin e substancave të Klasit 1,
- transportin e gazrave toksike, të paqëndrueshme dhe/ose të djegshme të Klasit 2,
- transportin e substancave që përmbajnë dioksinë ose furan,
- transportin në cisterna ose cisterna mbajtëse prej më shumë se 3 000 litra të lëngjeve të Klasit 3, 4.2, 4.3, 5.1, 6.1 ose 8 të cilat nuk paraqiten nën (b) ose (c) në këto klasa.

Dispozita të tilla lidhen vetëm me:

- ndalimin e operacioneve të transporteve të tilla me rrugë tokësore, ku mundësohet transporti i tyre me rrugë hekurudhore ose nënujore,
 - kërkesë për të ndjekur disa rrugë private,
 - dispozita të tjera që lidhen me ambalazhimin e substancave që përmbajnë dioksinë ose furan.
- Këto dispozita nuk mund të lirohen apo të bëhen më të lehta. Shtetet Anëtare ia komunikojnë këto dispozita kombëtare Komisionit, i cili informon Shtetet tjera Anëtare në përputhje me rrethanat.

Neni 6

1. Çdo Shtet Anëtar mund të autorizojë transportin me rrugë tokësore brenda territorit të tyre të mallrave të rrezikshme, të klasifikuar, ambalazhuar dhe etiketuar në përputhje me kërkesat ndërkombëtare për transportin detar ose ajror, në ato raste kur transporti përfshin një udhëtim detar ose ajror.
2. Çdo dispozitë në shtojcat A dhe B, në lidhje me përdorimin e gjuhëve në shënime, dokumente të rëndësishme, nuk zbatohet në operacionet e transportit të izoluara në territoret e vetëm një Shteti Anëtar. Shtetet Anëtare autorizojnë përdorimin e gjuhëve, përveç atyre të paraqitura në shtojcat për operacionet e transportit të kryera brenda territoreve të tyre.
3. Brenda territorit të tij, çdo Shtet Anëtar autorizon përdorimin e mjeteve të ndërtuara përpara datës 1 janar 1997, e cila nuk përputhet me këtë direktivë, por u ndërtua në përputhje me kërkesat kombëtare në fuqi më 31 dhjetor 1996, me kusht që mjete të tilla të ruhen në nivelet e sigurisë së kërkuar.
4. Çdo Shtet Anëtar i ruan dispozitat e legjislacionit kombëtar në fuqi më 31 dhjetor 1996 në lidhje me ndërtimin, përdorimin dhe kushtet e transportit të mbajtëses së re të kuptimit të

Margjinalit 2 212 të Shtojcës A, si dhe detyra të reja, të cilat nuk përputhen me Shtojcat A dhe B, deri sa referencat e standardeve për ndërtimin dhe përdorimin e cisternave dhe mbajtëseve me të njëjtën forcë detyruese, ashtu si dispozitat e kësaj direktive i shtohen Shtojcës A dhe B, dhe në çdo rast jo më vonë se 31 dhjetor 1998. Mbajtëset dhe tanket e ndërtuara përpara datës 1 janar 1999 dhe që ruajnë nivelet e duhura të sigurisë vazhdojnë të përdoren sipas kushteve origjinale.

5. Çdo Shtet Anëtar ruan dispozita kombëtare, përveç atyre të vendosura në Shtojcat A dhe B, në lidhje me temperaturat e përmendura për transportin brenda territorit të tij të lëngjeve të lëngëta apo atyre të lëngëta të përziera, derisa dispozitat në lidhje me të dhënat e duhura të temperaturave për zonat klimatike të caktuara të futen në standardet dhe referencat europiane të atyre standardeve të shtuara në Shtojcat A dhe B.
6. Çdo Shtet Anëtar lejon përdorimin për transport brenda territorit të tij, të ambalazheve të bëra, por jo e certifikuar sipas ADR-së para datës 1 janar 1997, e cila siguroi që një ambalazhim i tillë të ketë datën e prodhimit dhe të kalojë provat e paraqitura në legjislacionin në fuqi të datës 31 dhjetor 1996, si dhe siguroi që këto ambalazhime të ruhen në nivelet më të larta të sigurisë (duke përfshirë provat dhe hetimet aty ku kërkohet), sipas skemës së mëposhtme: konteinere voluminoze metalike të madhësisë mesatare dhe tambure metalike, që i tejkalojnë 50 litrat, deri në 15 vite pas datës së tyre të prodhimit; ambalazhime të tjera metali dhe të gjitha ambalazhimet plastike deri në 5 vite pas datës së prodhimit; ambalazhime të tjera metali dhe të gjitha ambalazhimet plastike deri në 5 vite pas datës së prodhimit, por jo pas datës 31 dhjetor 1998.
7. Çdo Shtet Anëtar lejon transportin brenda territorit të tij të paketimeve të disa mallrave të rrezikshme para datës 1 janar 1997 deri më 31 dhjetor 1998, e cila siguroi që mallrat klasifikohen, paketohen dhe etiketohen sipas kërkesave të legjislacionit kombëtar në fuqi para datës 1 janar 1997.
8. Çdo Shtet Anëtar ruan dispozitat e legjislacionit kombëtar në fuqi më 31 dhjetor 1996 në lidhje me afishimin e kodit të veprimit urgjent në vend të numrit të identifikimit të rrezikut, të paraqitura në Shtojcën B për operacionet e transportit të kryera brenda territorit të tij nga mjete të regjistruara po brenda këtij territori.
9. Çdo Shtet Anëtar, pasi konsultohet me Komisionin, i ruan dispozitat jo aq të rrepta sa ato të vendosura në Shtojcat A dhe B të kësaj direktive për transportin brenda territorit të tij të sasive të vogla të disa mallrave të rrezikshme, më përjashtim të substancave që kanë nivel të mesëm apo të lartë radioaktiviteti.
10. Me kusht që siguria nuk cenohet, Shtetet Anëtare, garantojnë shmangie të përkohshme nga Shtojcat A dhe B, me qëllim të përmbushin brenda territoreve të tyre provat e nevojshme para ndryshimit të atyre shtojcave, për t'i përshtatur ato me zhvillimet teknologjike dhe industriale. Komisioni informohet prej saj dhe informon Shtetet tjera Anëtare sipas rrethanave.
Një shmangie e përkohshme e arritur me marrëveshje mes autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare në bazë të Marxhinaleve 2 010 dhe 10 602 të Shtojcave A dhe B, merr formën e marrëveshjes shumëpalëshe, që i propozohet të gjitha autoriteteve kompetente të

Shteteve Anëtare nga autoriteti, duke marrë iniciativë në lidhje me marrëveshjen. Komisioni informohet sipas rrethanave.

Çdo shmangie, ashtu siç u paraqit në dy paragrafet e mësipërme, zbatohet pa diskriminim për shkak të shtetësisë ose vendit të ndërmarrjes së dërguesit, transportuesit ose marrësit të dërgesës; ata mund të zgjasin deri në pesë vite dhe nuk përsëriten.

11. Çdo Shtet Anëtar autorizon një transport unik të mallrave të rrezikshme, të cilat ndalohen ose nga Shtojcat A dhe B, ose kryhen sipas kushteve të ndryshme nga ato të paraqitura në Shtojcat A dhe B.
12. Pa cenuar paragrafin 2, çdo Shtet Anëtar mund të zbatojë marrëveshje ekzistuese me Shtetet tjera Anëtare që përputhen me ADR-në, jo më vonë se data 31 dhjetor 1998, pa diskriminim për shkak të shtetësisë ose vendit të ndërmarrjes së dërguesit, transportuesit ose marrësit të dërgesës. Çdo shmangie tjetër e autorizuar nga Margjinalet 2 010 dhe 10 602 të Shtojcave A dhe B përputhet me paragrafin 10.

Neni 7

Subjekt i dispozitave kombëtare apo i dispozitave të Komunitetit në tregun e lirë, mjetet e regjistruara apo që qarkullojnë në shtetet joanëtare, autorizohen të kryejnë transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme brenda Komunitetit, nëse transporti në fjalë përputhet me ADR-në.

KAPITULLI III DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 8

Ndryshimet e nevojshme për të përshtatur Shtojcat A dhe B përparimeve shkencore dhe teknologjike në fushat e mbuluara nga kjo direktivë, me qëllim të marrë parasysh ndryshimet e Shtojcave të ADR-së, përshtatet në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 9.

Neni 9

1. Komisioni ndihmohet nga një komitet në transportin e mallrave të rrezikshme, quajtur më poshtë “Komiteti” i cili përfshin përfaqësuesit e Shteteve Anëtare dhe drejtohet nga një përfaqësues i Komisionit.

2. Përfaqësuesi i Komisionit i dërgon Komitetit një draft për masat që duhet të merren. Komiteti jep opinionin e tij në këtë draft brenda një kohe të caktuar, të cilën kryetari e cakton sipas nevojës urgjente që ka çështja. Opinioni vendoset nga shumica e caktuar në nenin 148 pika 2 të Traktatit në rast vendimesh, të cilat i kërkohen Këshillit t’i përshtasë në një propozim nga Komisioni. Votat e përfaqësuesve të Shteteve Anëtare brenda Komitetit vlerësohen sipas mënyrës së përcaktuar në atë nen. Kryetari nuk voton.

3. (a) Nëse masat e parashikuara nuk janë në përputhje me opinionin e Komitetit ose nëse nuk jepet opinion, Komisioni pa vonuar i dërgon Këshillit një propozim në lidhje me masat që duhen marrë. Këshilli vendos me shumicë të cilësuar.

(b) Nëse Këshilli nuk vepron brenda tre muajve të datës së referimit në Këshill, Komisioni miraton masat e propozuara.

Neni 10

1. Shtetet Anëtare miratojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat që iu nevojiten, sipas kësaj direktive para datës 1 janar 1997. Ata menjëherë informojnë Komisionin e tyre.

Kur Shtetet Anëtare miratojnë ato masa, ata përfshijnë referencat ose i shoqërojnë ato me referenca të tilla në botimin e tyre zyrtar. Shtetet Anëtare përcaktojnë mënyrën se si bëhen këto referenca.

2. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstet e dispozitave kryesore të ligjit kombëtar, të cilin ata e përshtasin në fushën e drejtuar nga kjo direktivë.

Neni 11

1. Direktiva 89/684 KEE shfuqizohet nga afati i fundit për zhvendosjen e kësaj direktive në legjislacionin kombëtar.

2. Certifikatat e përkohshme të lëshuara sipas nenit 4 pika 2 të asaj direktive vetëm për transportin kombëtar, mbeten të vlefshme deri më 31 dhjetor 1996. Certifikatat e lëshuara sipas nenit 4 pika 4 të asaj direktive vazhdojnë të përdoren deri në fund të afatit të tyre të vlefshmërisë, por jo më vonë se 1 korrik 1997 për mallrat e rrezikshme të transportuara në cisterna ose për eksplozivët, dhe jo më vonë se data 1 janar 2000 për mallrat e tjera të rrezikshme.

Neni 12

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 21 nëntor 1994.

Për Këshillin

Presidenti

M. Wissmann

SHTOJCA A

Marxhinalet 2 000 deri në 3 999 të Shtojcës A të Marrëveshjes Europiane në Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me Rrugë Tokësore (ADR), hyjnë në fuqi më 1 janar 1995, “Shtetet Anëtare” zëvendësohen nga “Palët Kontraktuese”.

NB: Versionet në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunitetit publikohen në momentin që teksti i konsoliduar është bërë gati dhe përkthimet janë plotësuar.

SHTOJCA B

Marxhinalet 10 000 deri në 260 000 të Shtojcës B të Marrëveshjes Europiane në Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me Rrugë Tokësore (ADR), hyjnë në fuqi më 1 janar 1995, “Shtetet Anëtare” zëvendësohen nga “Palët Kontraktuese”.

NB: Versionet në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunitetit publikohen në momentin që teksti i konsoliduar është bërë gati dhe përkthimet janë plotësuar.